



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike



Tiranë, më 06.09.2022

K Ë R K E S Ë

KËRKUES:

28 DEPUTETË TË KUVENDIT TË SHQIPËRISË (JO MË PAK SE 1/5 E DEPUTETËVE), me adresë njoftimi: Kuvendi i Shqipërisë, Blv. Dëshmorët e Kombit Nr. 4, Tiranë.

SUBJEKTE

TË INTERESUARA:

KËSHILLI I MINISTRAVE, me adresë njoftimi: Blv. Dëshmorët e Kombit, Tiranë.

KUVENDI I SHQIPËRISË, me adresë njoftimi: Blv. Dëshmorët e Kombit, Tiranë.

OBJEKTI:

1. Shfuqizimi i ligjit nr. 39/2022 “Për miratimin e aktit normativ nr. 5, datë 12.03.2022 “Për disa shtesa në ligjin nr. 8450, datë 24.02.1999, “Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre”, të ndryshuar””.
2. Shfuqizimi i ligjit nr. 42/2022 “Për miratimin e aktit normativ nr. 8, datë 25.03.2022 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8450, datë 24.02.1999, “Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre”, të ndryshuar””.

BAZA LIGJORE:

Nenet 11, 18, 101, 131 dhe 134 të Kushtetutës së Shqipërisë;
Neni 71 i ligjit nr. 9550, datë 27.7.2006 “Për ratifikimin e “Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Komuniteteve Europiane të shteteve të tyre anëtare”;

Nenet 27, 49, 50 dhe 51 të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar.

DREJTUAR:

**GJYKATËS KUSHTETUESE
TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

E Nderuar Znj. Kryetare,
Të Nderuar Gjyqtarë,

Në datën 21.04.2022, Kuvendi i Shqipërisë, me shumicë votash, ka miratuar ligjin nr. 39/2022 “Për miratimin e aktit normativ, me fuqinë e ligjit, nr. 5, datë 12.03.2022, “Për disa shtesa në ligjin nr. 8450, datë 24.02.1999, “Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre”, të ndryshuar””, dhe ligjin nr. 42/2022 “Për miratimin e aktit normativ, me fuqinë e ligjit, nr. 8, datë 25.03.2022, “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8450, datë 24.02.1999, “Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre”, të ndryshuar””. Duke qenë se vlerësojmë se këto dy akte vijnë në kundërshtim me nenet 11, 18 dhe 101 të Kushtetutës së Shqipërisë, jurisprudencën e Gjykatës Kushtetuese dhe nenin 71 të Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit ndërmjet Shqipërisë dhe Bashkimit Evropian, po parashtrijmë këtë kërkesë me faktet, provat, të drejtën e aplikueshme dhe arsyetimin ligjor, duke kërkuar shfuqizimin e ligjit nr. 39/2022 dhe ligjit nr. 42/2022.

I. RRETHANAT E CËSHTJES

1. Në datën 12.03.2022, Këshilli i Ministrave ka miratuar aktin normativ nr. 5, “Për disa shtesa në ligjin nr. 8450, datë 24.02.1999 “Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre”, të ndryshuar”. (**Prova nr. 1 – Akti normativ nr. 5, datë 12.03.2022 i Këshillit të Ministrave**) Ky akt përcakton shtimin e kreut III/1 në ligjin nr. 8450, datë 24.02.1999. Në përmbajtje të këtij kreu, përcaktohet kuptimi i situatës së vecantë, si një situatë emergjente, kur tregu hidrokarbur karakterizohet nga: a) reduktimi i përshpejtuar deri në mungesë i furnizimit me naftë, gaz dhe nënprodukte të tyre; b) rritja e ndjeshme e cmimit të tyre në treg; c)

zvogëlimi në mënyrë të ndjeshme i importeve mesatare të naftës/gazit dhe nënprodukteve të tyre, krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të mëparshëm, për shkak të mungesave në tregun ndërkombëtar; ç) zvogëlimi në mënyrë të argumentuar në një shkallë të tillë që pasojat e pafavorshme të shkaktuara nga kjo situatë nuk mund të shmangen a të parandalohen pa përcaktimin e masave në përputhje me këtë kre; dhe d) cdo situatë tjetër e krijuar në tregun ndërkombëtar, e cila ka sjellë deformime në tregun vendas. Situata e vecantë shpallet me vendim të Këshillit të Ministrave (*shih nenin 21/1*).

2. Për zbatimin e këtij akti, parashikohet ngritja e Bordit të Transparencës dhe Kufizimit të Përkohshëm të Cmimeve të Tregtimit me Shumicë/Pakicë të Nënprodukteve të Naftës dhe Gazit (në vijim “Bordi”). Bordi do të ketë në përbërje 12 anëtarë, 7 nga institucionet shtetërore dhe 5 përfaqësues nga shoqëritë e hidrokarbureve. Bordi kryesohet nga ministri i Ekonomisë (*shih nenin 21/2*). Në listën e kompetencave të dhëna këtij Bordi, përfshihet vendosja dhe njoftimi i cmimeve tavan për naftën, gazin dhe nënproduktet e tyre; vendosja e masave administrative ndaj shoqërive që nuk zbatojnë vendimet e Bordit; si dhe cdo kompetencë tjetër që vlerësohet e nevojshme sipas këtij kreu (*shih nenin 21/3*). Vendimet e Bordit në terren do të monitorohen nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve nëpërmjet verifikimit të faturave tatimore dhe Inspektoriati Shtetëror i Mbikëqyrjes së Tregut, nëpërmjet kontrolleve ose ankesave të qytetarëve (*shih nenin 21/4*).

3. Në vijim, akti normativ ka përcaktuar metodologjinë e përlllogaritjes së cmimit (*shih nenin 21/5*) dhe masat administrative në vlerat monetare në rast moszbatimi të vendimeve të Bordit, ku *in extremis* përfshihet edhe heqja e licencës së tregtimit, në rast të përsëritjes së shkeljes (*shih nenin 21/6*). Dhënia e masave administrative me gjobë është kompetencë e Inspektoriatit Shtetëror të Mbikëqyrjes së Tregut, ndërsa vendimi për heqjen e licencës së tregtimit merret nga Bordi (*shih nenin 21/8*). Ndaj këtyre masave, subjektet e sanksionuara mund të ushtrojnë ankim administrativ apo në gjykatë, varësisht nga lloji i sanksionit (*shih nenin 21/11*). Akti normativ nuk përcakton asnjë afat të vecantë për kohëzgjatjen e situatës së vecantë, duke e lënë tërësisht në diskrecionin e anëtarëve të Bordit (*shih nenin 21/10, pika 2*).

4. Akti normativ nr. 5/2022 është depozituar në Kuvendin e Shqipërisë në datën 16.03.2022. Pas shqyrtimit të tij në komisionet për dhënie mendimi, përkatësisht Komisionin për Cështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut në datën 12.04.2022 dhe Komisionin për Ekonominë dhe Financat në datën 19.04.2022, i ka kaluar për shqyrtim komisionit përgjegjës, Komisionit për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin, i cili me shumicë

votash e ka miratuar në datën 19.04.2022 dhe ia kaluar për shqyrtim seancës plenare. Në seancën plenare të datës 21.04.2022, me 73 vota pro, 39 vota kundër dhe 1 votë abstenim, Kuvendi i Shqipërisë ka vendosur miratimin e aktit normativ, me fuqinë e ligjit, nr. 5, datë 12.03.2022, nëpërmjet ligjit nr. 39/2022. **(Prova nr. 2 – Ligji nr. 39, datë 21.04.2022 i Kuvendit të Shqipërisë)**

5. Në datën 25.03.2022, Këshilli i Ministrave ka miratuar aktin normativ nr. 8, “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8450, datë 24.02.1999, “Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre”, të ndryshuar”. **(Prova nr. 3 – Akti normativ nr. 8, datë 25.03.2022 i Këshillit të Ministrave)** Ky akt normativ sillte disa ndryshime në aktin normativ nr. 5, datë 12.03.2022. Konkretisht, ky akt sillte një metodologji të re të përlllogaritjes së cmimit, duke reflektuar kërkesat e shoqërive të hidrokarbureve, të cilat kanë pretenduar marzhe më të larta sa i përket mbulimit të kostove të tyre. Në cmim shtoheshin të gjitha detyrimet doganore, përkatësisht akciza, taksa e qarkullimit, taksa e karbonit, TVSH në import, tarifa e markimit dhe skanimit (*shih nenin 2*). Në vijim, akti normativ ka ndryshuar masat administrative, duke hequr gjobat, dhe vendosur vetëm pezullimin e licencës për një periudhë 3-mujore për shkeljen e parë, dhe në rast vazhdimi apo përsëritje të shkeljes, Bordi vendos heqjen e licencës së ushtrimit të veprimtarisë tregtare dhe sekuestrimin e stacionit të shitjes së karburantit (*shih nenin 3*).

6. Akti normativ nr. 8/2022 është depozituar në Kuvendin e Shqipërisë në datën 04.04.2022. Pas shqyrtimit të tij në komisionet për dhënie mendimi, përkatësisht në Komisionin për Cështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut në datën 12.04.2022 dhe në Komisionin për Ekonominë dhe Financat në datën 19.04.2022, akti i ka kaluar për shqyrtim komisionit përgjegjës, Komisionit për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin, i cili me shumicë votash e ka miratuar në datën 19.04.2022 dhe ia ka kaluar për shqyrtim seancës plenare. Në seancën plenare të datës 21.04.2022, me 73 vota pro, 39 vota kundër dhe 2 vota abstenim, Kuvendi i Shqipërisë ka vendosur miratimin e aktit normativ, me fuqinë e ligjit, nr. 8, datë 25.03.2022, nëpërmjet ligjit nr. 42/2022. **(Prova nr. 4 – Ligji nr. 42, datë 21.04.2022 i Kuvendit të Shqipërisë)**

II. E DREJTA E APLIKUESHME

7. Kushtetuta e Shqipërisë:

(i) Neni 11 parashikon: “1. Sistemi ekonomik i Republikës së Shqipërisë bazohet në pronën private e publike, si dhe në ekonominë e tregut dhe në lirinë e veprimtarisë ekonomike. 3. Kufizime të lirisë së veprimtarisë ekonomike mund të vendosen vetëm me ligj dhe vetëm për arsye të rëndësishme publike.”

(ii) Neni 18 parashikon: “1. Të gjithë janë të barabartë përpara ligjit. 2. Askush nuk mund të diskriminohet padrejtësisht për shkaqe të tilla si gjinia, raca, feja, etnia, gjuha, bindjet politike, fetare a filozofike, gjendja ekonomike, arsimore, sociale ose përkatësia prindërore. 3. Askush nuk mund të diskriminohet për shkaqet e përmendura në paragrafin 2, nëse nuk ekziston një përligjje e arsyeshme dhe objektive.”

(iii) Neni 101 parashikon: “Këshilli i Ministrave, në rast nevojë dhe urgjence, nën përgjegjësinë e tij, mund të nxjerrë akte normative që kanë fuqinë e ligjit, për marrjen e masave të përkohshme. Këto akte normative i dërgohen menjëherë Kuvendit, i cili mbledhet brenda 5 ditëve nëse nuk është i mbledhur. Këto akte humbasin fuqinë nga fillimi, në qoftë se nuk miratohen nga Kuvendi brenda 45 ditëve.”

(iv) Neni 131 parashikon: “1. Gjykata Kushtetuese vendos: a) pajtueshmërinë e ligjit me Kushtetutën ose me marrëveshjet ndërkombëtare, sic parashikohet në nenin 122.”

(v) Neni 134 parashikon: “1. Gjykata Kushtetuese vihet në lëvizje me kërkesë të: c) jo më pak se një të pestës së deputetëve.”

8. Ligji Nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese”:

(i) Neni 27 parashikon: “1. Kërkesa në Gjykatën Kushtetuese paraqiten nga kërkuesi ose përfaqësuesi i zgjedhur prej tij. Në rast se kërkuesi ka zgjedhur të përfaqësohet nga një avokat, ai i bashkëngjijt kërkesës aktin e përfaqësimit. Në një rast të tillë të gjitha njoftimet e Gjykatës i drejtohen përfaqësuesit të kërkuesit.”

(iii) Neni 49 parashikon: “1. Të drejtën për të vënë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese për pajtueshmërinë e ligjit ose të akteve të tjera normative me Kushtetutën ose me marrëveshjet

ndërkombëtare e kanë: Presidenti i Republikës, Kryeministri ose jo më pak se një e pesta e deputetëve dhe Avokati i Popullit.”

(iv) Neni 50 parashikon: “1. Kërkesat në Gjykatën Kushtetuese për pajtueshmërinë e ligjit ose të akteve të tjera normative me Kushtetutën ose me marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara, sipas pikës 1 dhe pikës 3, shkronjat “a”, “b”, “c”, “c”, dhe “d” të nenit 49 të këtij ligji, mund të paraqiten brenda dy vjetëve nga hyrja në fuqi e aktit.”

(v) Neni 51 parashikon: “1. Gjatë shqyrtimit të kërkesave të parashikuara nga nenet 49 e 50 të këtij ligji, Gjykata Kushtetuese vlerëson: a) përmbajtjen e ligjeve dhe të akteve normative; b) formën e ligjeve dhe të akteve normative; c) procedurën për miratimin, shpalljen dhe hyrjen në fuqi të tyre.”

9. Ligji nr. 9590, datë 27.07.2006 “Për ratifikimin e “Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Komuniteteve Evropiane të Shteteve të Tyre Anëtare””:

(i) Neni 71 parashikon: “1. Dispozitat në vijim nuk përputhen me funksionimin e duhur të Marrëveshjes, duke qenë se mund të ndikojnë në tregtinë ndërmjet Komunitetit dhe Shqipërisë: (i) të gjitha marrëveshjet ndërmjet sipërmarrjeve, vendimet e marra nga grupe sipërmarrjesh dhe praktikat e koordinuara ndërmjet sipërmarrjeve të cilat kanë si objektive të tyre ose pasojë, parandalimin, kufizimin ose shtrembërimin e konkurrencës; (ii) abuzimi me pozicionin dominues, nga një ose më shumë sipërmarrje, në territoret e Komunitetit apo të Shqipërisë si një e tërë ose në një pjesë të konsiderueshme të tyre; (iii) cdo ndihmë shtetërore e cila shtrembëron ose rrezikon të shtrembërojë konkurrencën duke favorizuar sipërmarrje të caktuara ose prodhime të caktuara. 2. Praktikrat në kundërshtim me këtë nen vlerësohen në bazë të kriterëve që lindin nga zbatimi i rregullave të konkurrencës të aplikueshme në Komunitet, sidomos në nenet 81, 82, 86 dhe 87 të Traktatit themelues të Komunitetit Europian dhe instrumenteve interpretuese që përdoren nga institucionet e Komunitetit.”

III. ANALIZA LIGJORE

A. Lidhur me legjitimimin e kërkesit

A.1 Për legjitimimin ratione personae

10. Një grup prej 28 deputetësh, që përbëjnë 1/5 e të gjithë anëtarëve të Kuvendit të Shqipërisë, paraqesin kërkesën përpara Gjykatës Kushtetuese për shfuqizimin e ligjit nr. 39/2022 “Për miratimin e aktit normativ, me fuqinë e ligjit, nr. 5, datë 12.03.2022, “Për disa shtesa në ligjin nr. 8450, datë 24.02.1999, “Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre”, të ndryshuar””, dhe ligjit nr. 42/2022 “Për miratimin e aktit normativ, me fuqinë e ligjit, nr. 8, datë 25.03.2022, “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8450, datë 24.02.1999, “Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre”, të ndryshuar””.

11. Në lidhje me legjitimimin e subjektit kushtetues jo më pak se një e pesta e deputetëve për inicimin e kontrollit abstrakt të normës ligjore, Gjykata Kushtetuese në mënyrë të vazhdueshme ka vlerësuar se ky subjekt, i parashikuar në nenin 134, pika 1, shkronja “c”, të Kushtetutës dhe nenin 49, pika 1, të ligjit nr. 8577/2000, bën pjesë në subjektet që kanë të drejtë të vënë në lëvizje juridiksionin kushtetues për arsye të një interesi publik, pa u kushtëzuar me një interes subjektiv konkret. Interesi i këtyre funksionarëve publikë për të mbrojtur sistemin normativ dhe parimet shtetformuese, si konstitucionalizmi, shteti i së drejtës, demokracia, dinjiteti njerëzor, barazia sociale etj., të shpalosura në Kushtetutë, nuk është i kushtëzuar (*shih vendimin nr. 55, datë 27.07.2015 të Gjykatës Kushtetuese*).

12. Kontrolli abstrakt i kushtetutshmërisë së normës mund të zbatohet ndaj akteve ligjore pavarësisht nga efekti që ato mund të kenë në një konflikt aktual ose të pritshëm dhe, në një rast të tillë, nuk kërkohet ardhja e pasojës për të legjitimuar këtë subjekt para Gjykatës, pasi interesi që kërkohet të mbrohet nuk është thjesht individual, por lidhet me respektimin e parimeve kushtetuese dhe me funksionimin e rregullt të shtetit të së drejtës. Qëllimi i kontrollit të kushtetutshmërisë së ligjeve është njëkohësisht edhe parandalimi i pasojave negative që mund të vijnë nga zbatimi i tyre (*shih vendimet 2, datë 18.01.2017; nr. 25, datë 28.04.2014; nr. 9, datë 23.03.2010 të Gjykatës Kushtetuese*).

13. Në kuptim të sa më sipër, një grup prej 28 deputetësh të Kuvendit të Shqipërisë, në cilësinë e subjektit kushtetues jo më pak se një e pesta e deputetëve, përfaqëson një subjekt të pakushtëzuar, i cili nuk ka nevojë të provojë interesin e tij të drejtpërdrejtë në lidhje me çështjen në shqyrtim për shkak të interesit publik që mbart, dhe si i tillë, legjitimohet të vërë në lëvizje këtë gjykim kushtetues për kontrollin abstrakt të kushtetutshmërisë së aktit normativ të kundërshtuar.

A.2 Për legjitimimin ratione temporis

14. Neni 50, pika 1 e ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, përcakton se “Kërkesat në Gjykatën Kushtetuese për pajtueshmërinë e ligjit ose të akteve të tjera normative me Kushtetutën ose me marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara, sipas pikës 1 dhe pikës 3, shkronjat “a”, “b”, “c”, “ç” dhe “d”, të nenit 49, të këtij ligji, mund të paraqiten brenda dy vjetëve nga hyrja në fuqi e aktit.” Akti normativ nr. 5 “Për disa shtesa në ligjin nr. 8450, datë 24.02.1999, “Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre”, të ndryshuar”, është miratuar nga Këshilli i Ministrave në datën 12.03.2022. Ky akt normativ është miratuar nga Kuvendi i Shqipërisë me ligjin nr. 39, në datën 21.04.2022. Ndërsa, akti normativ nr. 8 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8450, datë 24.02.1999, “Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre”, të ndryshuar”, është miratuar nga Këshilli i Ministrave në datën 25.03.2022. Ky akt normativ është miratuar nga Kuvendi i Shqipërisë me ligjin nr. 42, në datën 21.04.2022. Cilado qoftë data, nga e cila do të përlllogaritet afati 2-vjecar për paraqitjen e kërkesës, në cdo rast subjekti kushtetues prej jo më pak se 1/5 e deputetëve të Kuvendit, legjitimohet në kohë për paraqitjen e kësaj kërkesë.

B. Lidhur me procedurën parlamentare

15. Neni 51, pika 1 e ligjit nr. 8577/2000 ka përcaktuar se “Gjatë shqyrtimit të kërkesave të parashikuara nga nenet 49 e 50 të këtij ligji, Gjykata Kushtetuese vlerëson: b) formën e ligjeve dhe të akteve normative; c) procedurën për miratimin, shpalljen dhe hyrjen në fuqi të tyre.” Rregullat sa i përket formës dhe procedurës parlamentare për miratimin e një ligji, gjenden në Rregulloren e Kuvendit të Shqipërisë. Kjo e fundit, në nenin 68, pika 2 të saj ka përcaktuar se

“Projektligji hartohet në formën e një akti normativ dhe shoqërohet me një relacion, i cili përmban: a) objektivat që synohen të arrihen me miratimin e tij; b) argumentet se objektivat nuk mund të arrihen me instrumentet ligjore ekzistuese; c) përputhshmërinë e projektligjit me Kushtetutën, harmonizimin me legjislacionin në fuqi dhe legjislacionin e Bashkimit European; ç) ndikimin ekonomik, social, mjedisor dhe ndjeshmërinë gjinore; d) shkallën e përmbushjes së objektivave të axhendës së zhvillimit të qëndrueshëm të Kombeve të Bashkuara, si dhe zbatimin e angazhimeve që rrjedhin prej saj; dh) përmbushjen e detyrimeve që burojnë nga angazhimet e shtetit shqiptar në kuadër të anëtarësimit në organizma dhe akte ndërkombëtare ku Shqipëria është palë.” Në rast se relacioni nuk përmbush të gjitha kërkesat e mësipërme, paragrafi i katërt i nenit 68 ka përcaktuar se “Kryetari i Kuvendit, në mënyrë të arsyetuar, mund të kthejë të nismëtari projektligjet e depozituara, në rast se nuk përmbushin kërkesat e parashikuara në pikën 2 të këtij neni.”

16. Duke u kthyer në rastin konkret, rezulton se akti normativ nr. 5, datë 12.03.2022 është shoqëruar me një relacion, i cili nuk përmbush disa prej kërkesave të përcaktuara në nenin 68, pika 2 të Rregullores së Kuvendit të Shqipërisë. Përkatësisht, në relacionin shoqërues të aktit normativ nuk gjenden seksionet që kanë të bëjnë me: ç) ndikimin ekonomik, social, mjedisor dhe ndjeshmërinë gjinore; d) shkallën e përmbushjes së objektivave të axhendës së zhvillimit të qëndrueshëm të Kombeve të Bashkuara, si dhe zbatimin e angazhimeve që rrjedhin prej saj; dhe dh) përmbushjen e detyrimeve që burojnë nga angazhimet e shtetit shqiptar në kuadër të anëtarësimit në organizma dhe akte ndërkombëtare ku Shqipëria është palë. **(Prova nr. 5 – Relacioni i aktit normativ nr. 5, datë 12.03.2022)** Madje, mungesa e një prej këtyre kërkesave, është pasqyruar edhe në raportin e komisionit parlamentar përgjegjës, Komisionit për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin, i cili shprehet në faqen 4 të raportit “*Relacioni shoqërues i aktit normativ nuk shprehet për përmbushjen e detyrimeve që rrjedhin nga Agjenda e Zhvillimit të Qëndrueshëm të Kombeve të Bashkuara, sic parashikohet në nenin 68, pika 2 e Rregullores.*” **(Prova nr. 6 – Raporti i Komisionit për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin, datë 19.04.2022)** Të njëjtën mangësi shfaqen edhe në relacionin e aktit normative nr. 8, datë 25.03.2022 **(Prova nr. 7 – Relacioni i aktit normativ nr. 7, datë 25.03.2022)** dhe i njëjti konstatim është bërë në faqen 3 të raportit të komisionit parlamentar përgjegjës, Komisionit për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin. **(Prova nr. 8 – Raporti i Komisionit për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin, datë 19.04.2022)**

17. Në kushtet kur relacionet shoqëruese të projektligjeve nuk përmbushnin kërkesat e nenit 68, pika 2 të Rregullores së Kuvendit, kryetarja e Kuvendit ka pasur detyrimin që, në mënyrë të arsyetuar, t'i kthente të dy aktet në Këshillin e Ministrave për rregullimin e të metave. Në shkelje të kësaj dispozite, kryetarja e Kuvendit nuk ka vepruar kështu, cka passjell që procedura parlamentare e ndjekur për shqyrtimin dhe miratimin e këtyre projektligjeve, të rezultojë me të meta. Në përputhje me përcaktimet e pikës 1 të nenit 51 të ligjit nr. 8577/2000, këto mangësi duhen vlerësuar nga Gjykata, në vlerësimin tërësor që do t'i bëhet kushtetutshmërisë së ligjit nr. 39/2022 dhe ligjit nr. 42/2022.

C. Lidhur me nxjerrjen e aktit normativ në kundërshtim me nenin 101 të Kushtetutës

18. Kushtetuta e Shqipërisë, në nenin 101, parashikon se Këshilli i Ministrave, në rast nevoje dhe urgjence, nën përgjegjësinë e tij, mund të nxjerrë akte normative që kanë fuqinë e ligjit, për marrjen e masave të përkohshme. Këto akte normative i dërgohen menjëherë Kuvendit, i cili mbledhet brenda 5 ditëve nëse nuk është i mbledhur. Ato humbasin fuqinë që nga fillimi, në qoftë se nuk miratohen nga Kuvendi brenda 45 ditëve.

19. Gjykata Kushtetuese, në rastet e shqyrtimit të kushtetutshmërisë së akteve normative, ka konsideruar se e drejta e Këshillit të Ministrave për të nxjerrë akte normative me fuqinë e ligjit, sipas parashikimeve të nenit 101 të Kushtetutës, përbën një përjashtim nga parimi kushtetues i njohjes dhe përqendrimit të pushtetit ligjvënës në duart e Kuvendit të Shqipërisë, duke lejuar nxjerrjen e akteve me fuqinë e ligjit edhe nga organe të tjera kushtetuese. Përdorimi i këtij instrumenti ligjvënës mbetet në vlerësimin e Këshillit të Ministrave, por cmohet se ushtrimi i kësaj kompetence gjërësisht dhe jo në kushtet e parashikuara nga Kushtetuta cënon pavarësinë e pushtetit legjislativ dhe karakterin demokratik të shtetit. Kjo e drejtë ka natyrë lejuese dhe përjashtimore, prandaj Kushtetuta, nëpërmjet nenit 101 i ka njohur të drejtën Këshillit të Ministrave të nxjerrë akte normative që kanë fuqinë e ligjit vetëm kur rasti shfaqet si i jashtëzakonshëm dhe *nevoja e urgjenca* e bëjnë të pamundur ushtrimin e kompetencës ligjvënëse nga Kuvendi (*shih vendimin nr. 24, datë 10.11.2006 të Gjykatës Kushtetuese*).

20. Gjykata Kushtetuese ka theksuar se nevoja dhe urgjenca janë elemente me rëndësi të vecantë në përmbajtjen e nenit 101 të Kushtetutës, dhe, si të tilla, janë përcaktuese për të drejtën që i njihet Këshillit të Ministrave për zbatimin e kësaj dispozite. Kuptimi i tyre është autonom, i

lidhur me tërësinë e përmbajtjes së dispozitës dhe me parimet bazë që përshkojnë Kushtetutën. Nevoja dhe urgjenca janë rrethana dhe situata fakti që vlerësohen rast pas rasti. Ato mund të shkaktohen nga faktorë të ndryshëm jetësorë, natyrorë e shoqërorë, si fatkeqësitë natyrore, boshllëku legjislativ i shkaktuar nga shfuqizimi i akteve, nevoja për efekte të menjëhershme në fusha me ndjeshmëri të madhe publike, parandalimi i menjëhershëm i spekulimeve. Ajo që i bashkon të gjitha këto situata është fakti se përfaqësojnë një gjendje jo të zakonshme në jetën e vendit, ku evidentohet dukshëm rreziku i ardhjes së pasojave të dëmshme për interesat publike ose për të drejtat themelore të shtetasve. Ky rrezik dikton nevojën e masave të menjëhershme, por që legjislacioni ekzistues nuk i mundëson dot (*shih vendimet nr. 24, datë 10.11.2006; nr. 1, datë 06.02.2013, të Gjykatës Kushtetuese*).

21. Nevoja dhe urgjenca duhen kuptuar si parakushte të domosdoshme, mungesa e të cilave do të kishte si pasojë pavlefshmërinë e aktit normativ me fuqinë e ligjit. Duke qenë kushte paraprake, nevoja dhe urgjenca duhet të jenë vërtetuar se ekzistojnë përpara momentit të marrjes të iniciativës nga qeveria për nxjerrjen e aktit normativ me fuqinë e ligjit. Këto dy kushte duhet të jenë gjithashtu të pranishme, të lidhura e të ndërvarura dhe në momentin kur nxirret akti normativ me fuqinë e ligjit. Vetëm kur situata e krijuar vlerësohet e pamundur të presë aq kohë sa nevojitet për nxjerrjen e ligjit të nevojshëm nga organi ligjvënës, qoftë edhe nëpërmjet procedurave të përshpejtuara, iniciativa ligjvënëse mund t'i kalojë qeverisë. Nëse nuk do të vlerësohej ky aspekt, qeveria do të merrte, pa të drejtë, funksionet ligjvënëse të Kuvendit (*shih vendimet nr. 24, datë 10.11.2006; nr. 1, datë 10.11.2006, të Gjykatës Kushtetuese*).

22. Gjykata Kushtetuese ka theksuar se elementi *urgjencë* nuk mund të ekzistojë në vetvete pa *nevojën*, sepse urgjenca tregon vetëm një situatë që nuk mund të presë, ndërsa nevoja tregon substancën e saj, përcakton situatën që kërkon zgjidhje, tregon marrëdhënien shoqërore që kërkon rregullim ligjor. Kuptimin e tyre të vërtetë termat *nevojë* dhe *urgjencë* e manifestojnë në kuadër të situatës së rastit konkret, duke i vlerësuar në kohën kur është vërtetuar prania e tyre. Nga kuptimi i përmbajtjes së nenit 101 të Kushtetutës, rezulton se vlerësimin e parë faktit dhe substancial të këtyre elementeve i përket ta bëjë qeveria. Ajo nuk mund të ndërmarrë një nismë për nxjerrjen e një akti normativ me fuqinë e ligjit, pa vlerësuar më parë rrethanat e krijuara që kanë shkaktuar nevojë dhe urgjencë. Natyra e vlerësimit që bën ky organ është faktik dhe juridik (*shih vendimet nr. 24, datë 10.11.2006; nr. 1, datë 10.11.2006 të Gjykatës Kushtetuese*).

23. Duke u kthyer në rastin konkret, qeveria kishte detyrim kushtetues që përpara se të miratonte aktet normative me fuqinë e ligjit, të kryente një analizë të fakteve dhe rrethanave konkrete, nëse përmbusheshin dy elementet e nenit 101 të Kushtetutës, përkatësisht nevoja dhe urgjenca. Ashtu sic del qartë nga mënyra e formulimit të kësaj dispozite kushtetuese, por edhe jurisprudenca kushtetuese, këto dy elemente janë kumulative, pra duhet të bashkëekzistojnë në mënyrë që akti normativ të konsiderohet i nxjerrë në përputhje me Kushtetutën. Madje, jurisprudenca kushtetuese ka shkuar një hap më tej, duke përcaktuar se që të ekzistojë elementi urgjencë, duhet të ndodhemi fillimisht në kushtet e nevojës, pasi është kjo e fundit që përcakton substancën e rregullimit. Pikërisht, këtë analizë të nevojës dhe urgjencës, Këshilli i Ministrave duhet ta parashtronte nëpërmjet të dhënave faktike në relacionet shoqëruese të akteve normative.

24. Por, në fakt nga përmbajtja e tyre rezulton se Këshilli i Ministrave është mjaftuar me një formulim të përgjithshëm si vijon: *“Projektakti normativ është hartuar në përputhje me nenin 101 të Kushtetutës, ku parashikohet e drejta e Këshillit të Ministrave për të nxjerrë akte rregullatore me fuqinë e ligjit. Kjo e drejtë ka natyrë lejuese dhe përjashtimore, prandaj Kushtetuta e ka kushtëzuar me ekzistencën e nevojës dhe urgjencës, si dhe me kontrollin përfundimtar nga Kuvendi të akteve të nxjerra. Nevoja dhe urgjenca janë elemente me rëndësi të vecantë në përmbajtjen e nenit 101 të Kushtetutës dhe, si të tilla, janë elemente përcaktuese për të drejtë që sanksionon kjo dispozitë.”* Një formulim kaq i përgjithshëm që nuk sjell asnjë të dhënë faktike apo reale sa i përket nevojës dhe urgjencës që ka diktuar nxjerrjen e akteve normative, do të ishte e mjaftueshme për të pavleftësuar këto dy akte. Gjykata Kushtetuese italiane është shprehur se vlerësimi i elementëve të nevojës dhe ekzistencës bazohet në një test që përfshin dekretligjin, relacionin shoqërues dhe kontekstin normativ në të cilin “përfshihet” projektligji (*shih vendimin nr. 270/1996 e Gjykatës Kushtetuese italiane*). Të dy relacionet shoqëruese të projektligjeve kanë dështuar të përmbushin standardet e vendosura nga jurisprudenca kushtetuese për të justifikuar në mënyrë të mjaftueshme bashkëekzistencën e nevojës dhe urgjencës.

25. Megjithatë, me të drejtë mund të thuhet se ekzistenca e këtyre dy elementeve duhet të ishte objekt i kontrollit parlamentar. Por, edhe nga raportet e komisioneve parlamentare, përkatësisht komisionit përgjegjës, Komisionit për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin, kjo analizë është mjaft e cekët dhe sipërfaqësore. Konkretisht, Komisioni në raportin e tij të datës 19.04.2022, shprehet se *“Rritja e cmimeve të produkteve dhe nënprodukteve të naftës dhe gazit në tregun ndërkombëtar e për rrjedhojë edhe në tregun shqiptar, krijoi një sërë*

problematikash, të cilat afektojnë normalitetin në vend, duke krijuar kështu një situatë të vecantë. Me qëllim adresimin e kësaj situatë lindi nevoja për të ndërhyrë në tregtimin e karburanteve në vend. Kjo ndërhyrje, për shkak të emergjencës u realizua nëpërmjet një akti normativ, i cili synon përcaktimin e masave të vecanta që do të merren ndaj subjekteve publike ose private, vengase apo të huaja, që ushtrojnë veprimtarinë e tyre në përpunimin, transportimin e tregtimin e naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre, gjatë të gjithë kohëzgjatjes së kësaj situatë të vecantë në tregun shqiptar.” Pra, edhe komisioni parlamentar, mjaftohet me një analizë të përgjithshme, pa të dhëna dhe detaje konkrete, që kanë diktuar nevojën për të ndërhyrë në mënyrë urgjente nëpërmjet një akti normativ me fuqinë e ligjit. Në cdo rast, mungon një analizë nëse mekanizmat ligjorë dhe institucionalë ekzistues janë të mjaftueshëm për realizimin e qëllimeve që kërkojnë të realizohen nëpërmjet këtyre akteve normative.

26. Tribunali Kushtetues spanjoll ka shfuqizuar dekretligje për mungesë të urgjencës, në ato raste kur arsyetimi mbështetej vetëm në arsye “teorike dhe abstrakte” (*shih vendimin nr. 68, datë 28.03.2007 të Tribunalit Kushtetues spanjoll*). Edhe në rastin konkret, vërehet se Këshilli i Ministrave dhe Komisioni parlamentar përgjegjës kanë dështuar të ofrojnë të dhëna dhe fakte konkrete, të cilat kanë diktuar nevojën e urgjencën e nxjerrjes së akteve normative me fuqinë e ligjit. Ekzistenca e një krizë botërore, një agresioni ushtarak, një pandemi globale etj., nuk mund të konsiderohen arsye të mjaftueshme për të ndërmarrë masa kufizuese të të drejtave të njeriut, përpara vlerësimit të mekanizmave ligjorë dhe institucionalë ekzistues, të cilët nëse përdoren me efektivitet mund të rezultojnë të mjaftueshëm për adresimin e situatës. Megjithëse, mungesa e justifikimit të mjaftueshëm të elementëve të nevojës dhe ekzistencës në relacionet e Këshillit të Ministrave dhe në raportet e komisionit parlamentar përgjegjës, është një tregues i qartë i mosekzistencës së këtyre dy elementeve në rastin konkret, në vijim do të ndalemi edhe në analizën e këtyre dy elementeve.

27. Nevoja, në kuptim të jurisprudencës kushtetuese, është përkufizuar si një situatë pamundësie për të vepruar në një mënyrë të ndryshme. E sjellë në rastin konkret, kjo do të thotë që qeveria shqiptare ishte në pamundësi për të vepruar ndryshe, përvecse duke miratuar një akt normativ që parashikon marrjen e disa masave të vecanta për mbrojtjen e konsumatorit nga rritja e përgjithshme e hidrokarbureve në tregun ndërkombëtar, që sipas qeverisë, rrjedhimisht prek edhe tregun vendas. E vërteta është se qeveria shqiptare ka pasur në dorë disa mekanizma ligjorë dhe institucionalë, të cilët mund të garantonin mbrojtjen e konsumatorit, pa pasur nevojë për miratimin

e një akti normativ me fuqinë e ligjit. Konkretisht, sic rezulton nga relacioni i aktit normativ nr. 8, datë 25.03.2022, mbi cmimin e hidrokarbureve aplikohen 5 detyrime doganore, përkatësisht (i) akciza; (ii) taksa e qarkullimit; (iii) taksa e karbonit; (iv) TVSH në import; dhe (v) tarifë markimi dhe skanimi. Këtyre pesë detyrimeve, iu shtohen edhe taksa e rilicencimit dhe kontrollit të pompave. Sipas një përlogaritje të kryer nga media të ndryshme rezulton se për cdo litër karburant, qytetarët dhe bizneset shqiptare paguajnë 112 lekë detyrime financiare ndaj shtetit (burimi: Top Channel dhe Monitor.al). Nëse qëllimi i qeverisë ka qenë mbrojtja e konsumatorit nga rritja e cmimit, atëherë mund të kishte proceduar me uljen apo pezullimin e disa prej këtyre detyrimeve, në mënyrë që cmimi të mbetej në nivele të pranueshme.

28. Nga ana tjetër, shumë qeveri të shteteve evropiane kanë vendosur subvencionimin me shuma monetare për rritjen e cmimeve. Ndërsa, sa i përket shqetësimit se operatorët ekonomikë mund të abuzonin, kuadri ligjor shqiptar, përkatësisht ligji nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës” dhe ligji nr. 9902, datë 17.04.2008 “Për Mbrojtjen e Konsumatorëve” ofrojnë mekanizmat e nevojshëm ligjorë dhe institucionalë për të mbrojtur qytetarët nga cdo abuzim që mund të bëhet në kurriz të tyre nga shoqëritë private. Në relacionin e Këshillit të Ministrave nuk gjendet asnjë rresht lidhur me faktin se mekanizmat ligjorë dhe institucionalë të mësipërm janë të mjaftueshëm për të realizuar mbrojtjen e konsumatorit nga rritja e cmimeve të hidrokarbureve. Në cdo rast, sic do ta shohim në vijim mekanizmat ligjorë dhe institucionalë të parashikuar në të dyja aktet normative kanë rezultuar të pamjaftueshme për të mbrojtur qytetarët dhe bizneset shqiptare, të cilët paguajnë sot cmimin më të lartë në rajon për blerjen e lëndëve hidrokarbure.

29. Gjykata Kushtetuese është shprehur qartë se nuk mund të ekzistojë urgjenca pa nevojën, cka do të thotë se do të mjaftonte të provohej mungesa e elementit nevojë për të konkluduar edhe mbi mungesën e urgjencës, në vijim do të ndalemi shkurtimisht edhe te ky element. Që nga 10 Marsi 2020 e në vijim, Shqipëria ka qenë në gjendjen e pandemisë COVID-19. Për shkak të kushteve që u krijuan në tregjet ndërkombëtare, kjo gjendje ka sjellë një rritje të përgjithshme të cmimeve, përfshirë cmimet e lëndëve hidrokarbure. Vazhdimisht gjatë kësaj periudhe 2-vjecare ka pasur një luhajtje në drejtim të rritjes së cmimit të gazit, naftës dhe nënprodukteve të tyre. Megjithëse, periudha 2-vjecare ishte mëse e mjaftueshme, qeveria shqiptare nuk solli asnjë projektligj apo nismë ligjore konkrete që synonte disiplinimin e operatorëve ekonomikë të tregut të hidrokarbureve. Edhe situata e tensioneve dhe konflikteve ndërmjet Ruisë dhe Ukrainës nuk

ishite një situatë krejtësisht e paparashikuar, pasi prej kohësh palët kishin kërcënuar njëra-tjetrën me luftë, dhe për shkak të rolit që këto dy shtete luajnë në tregun e hidrokarbureve, impakti që do të krijonin ishte deri diku i mjaftueshëm. Në këto kushte, urgjenca me të cilën qeveria ka kërkuar të justifikojë nxjerrjen e këtyre dy akteve normative vihet realisht në pikëpyetje. Nga ana tjetër, agresioni rus në Ukrainë filloi në datën 24 Shkurt 2022 dhe qeveria miratoi aktin e parë normativ në datën 12.03.2022 dhe aktin e dytë normativ në datën 25.03.2022, pra rreth një muaji pas fillimit të konfliktit të armatosur. Gjatë kësaj kohe, qeveria kishte mundësi që duke shfrytëzuar përcaktimet e nenit 83, pika 2 të Kushtetutës dhe nenit 28 të Rregullores së Kuvendit, të sillte një projektligj për shqyrtim me procedurë të përshpejtuar. Por, sic do të shohim në vijim, nxjerrja e akteve normative me fuqinë e ligjit nga një përjashtim nga rregulli, është shndërruar në rregull në praktikën qeverisëse 2013 – 2022.

30. Gjykata Kushtetuese është shprehur se dhënia e pushtetit ligjvënës Qeverisë ka karakter përjashtues ndaj pushtetit të Parlamentit për të miratuar normat primare të së drejtës. Kjo është arsyeja që, në vende të ndryshme, përfshihë edhe ato me demokraci të konsoliduar, kushtetutbërësi është treguar i përmbajtur në delegimin e pushtetit ligjvënës qeverisë, në respektim të parimit të sovranitetit, të ndarjes së pushteteve dhe të hierarkisë së burimeve të së drejtës (*shih vendimin nr. 5, datë 05.02.2014 të Gjykatës Kushtetuese*). Kuvendi, si organi më i lartë përfaqësues dhe mbartës i sovranitetit të popullit, ushtron në mënyrë ekskluzive funksionin e tij ligjvënës, me përjashtim të rasteve të rralla kur ky funksion i delegohet Këshillit të Ministrave, i cili në cdo rast i nënshtrohet kontrollit dhe miratimit parlamentar. Por, nga arkiva parlamentare, rezulton se nga data 01.10.2013 deri në datën 23.05.2022, Qeveria shqiptare ka miratuar 112 akte normative me fuqinë e ligjit, ose rreth 14 akte normative/vit, cka përbën një numër relativisht të lartë, i cili ka ardhur pikërisht për shkak të mungesës së kontrollit parlamentar të elementëve kushtetues të nevojës dhe urgjencës. Sic duket qeveria e ka shndërruar aktin normativ me fuqinë e ligjit në një praktikë normale pune, në një kohë kur në frymën dhe gërmën e Kushtetutës, akte të tilla duhet të nxirreshin vetëm në situata të vecanta. Ky element i shpeshhtësisë së përdorimit të këtij mekanizimi, duhet të merret në konsideratë nga Gjykata Kushtetuese në vlerësimin tërësor të kësaj kërkesë, edhe në drejtim të nenit 7 të Kushtetutës, sa i përket parimit të ndarjes së pushteteve.

C. Lidhur me cënimin e lirisë së veprimtarisë ekonomike

31. Kushtetuta, në nenin 11, pikat 1 dhe 3, parashikon se sistemi ekonomik bazohet në pronën private dhe publike, si dhe në ekonominë e tregut dhe në lirinë e veprimtarisë ekonomike, dhe se kufizimet e lirisë ekonomike mund të bëhen vetëm me ligj, për një arsye të rëndësishme publike. Gjykata Kushtetuese e ka interpretuar gjërësisht konceptin e lirisë së veprimtarisë ekonomike të garantuar nga neni 11 i Kushtetutës. Sipas saj, kjo liri nënkupton, kryesisht të drejtën për të lidhur kontrata, individualisht ose kolektivisht, lirisht dhe mbi bazën e vullnetit personal, të drejtën për të zgjedhur aktivitetin që dëshiron të ushtrojë individi, të drejtën për të zgjedhur një punë sipas preferencës së tij etj. Kjo liri përfshin të gjitha të drejtat që lidhen me prodhimin, shpërndarjen ose konsumin e mallrave dhe të shërbimeve. Liria e veprimtarisë ekonomike përmban në vetvete shumë të drejta dhe liri si: liria e biznesit ose aftësia për të krijuar dhe mbyllur një sipërmarrje, liria e tregtisë ose mungesa e barrierave lidhur me importimin dhe eksportimin e mallrave dhe shërbimeve, liria monetare si masë për të garantuar qëndrueshmëri të cmimit, liria fiskale mbi të ardhurat qoftë individuale, qoftë ndaj biznesit në mënyrë të vecantë, të drejtat e pronësi si aftësi e individëve për të grumbulluar, poseduar dhe disponuar sende, të lirë nga ndërhyrja e shtetit, liria e investimit dhe qarkullimit të lirë të kapitaleve, vecanërisht kapitalit të huaj, liria financiare dhe pavarësi nga kontrolli shtetëror, liria e punës për të ndërvepruar pa kufizime nga shteti (*shih vendimet nr. 10, datë 19.03.2008; nr. 19, datë 09.07.2009; nr. 24, datë 24.07.2009, të Gjykatës Kushtetuese*).

32. Duke u kthyer në rastin konkret, vlerësojmë se miratimi i një akti normativ me fuqinë e ligjit, i cili përcakton krijimin e një Bordi, me pjesëmarrje publike dhe private, që cakton cmimin e gazit, naftës dhe nënprodukteve të tyre, përbën një kufizim në lirinë e veprimtarisë ekonomike, pasi është e drejta e cdo operatori ekonomik në treg që të përcaktojë vetë cmimet e produkteve që ai tregton. Imponimi i cmimeve në mënyrë të detyruar përbën qartazi një ndërhyrje në ushtrimin e veprimtarisë ekonomike. Prandaj, në vijim do të analizojmë nëse ky kufizim përmbush kriteret e caktuara nga neni 17/1 i Kushtetutës, pra që janë bërë me ligj, për interes publik dhe nëse është në përpjestim me gjendjen që e ka diktuar marrjen e kësaj mase. Neni 17/1 i Kushtetutës, kërkesat e të cilit shtrihen ndaj të gjitha të drejtave dhe lirive të parashikuara në Kushtetutë, parashikon se *“kufizime të të drejtave dhe lirive të parashikuara në këtë Kushtetutë mund të vendosen vetëm me ligj, për një interes publik ose për mbrojtjen e të drejtave të të tjerëve. Kufizimi duhet të jetë në*

përpjesëtim me gjendjen që e ka diktuar atë.” Në këtë mënyrë, pajtueshmëria e masës kufizuese të marrë nga ligjvënësi me ekzistencës e nevojës së kufizimit duhet të verifikohet në aspektin e kushteve të vendosura në dispozitat e nenit 17 të Kushtetutës dhe konkretisht të ekzistencës së interesit publik.

33. Kriteri i parë për t’u analizuar është “kufizimi vetëm me ligj” i drejtave dhe lirive themelore të individit. Qëllimi i këtij kriteri është ofrimi i garancive sa më të plota në rastin e kufizimeve dhe, për këtë shkak, vetëm organi më i lartë ligjvënës duhet të jetë kompetent. Shprehja “vetëm me ligj” ka kuptimin që në rast se është i nevojshëm kufizimi i një të drejte të parashikuar në Kushtetutë, atëherë ky vlerësim është në cmim të ligjvënësit dhe jo të organeve të tjera. Konteksti në të cilin është përdorur togfjalëshi “kufizimi vetëm me ligj” nuk lejon të bëhet interpretim i zgjeruar. Kjo edhe për faktin se një interpretim i tillë i normave kushtetuese mund të bëhet vetëm në aspektin pozitiv, kur ky interpretim shkon në favor të mbrojtjes së të drejtave dhe jo e kundërta. Rregullimi i parashikuar në nenin 17 për kufizimin e të drejtave dhe lirive vetëm me ligj ka të bëjë edhe me përcaktimin e kompetencës së një organi konkret, që në këtë rast është Kuvendi. Një shprehje e tillë të referon në kompetencën e organit ligjvënës dhe nxjerrja e akteve të tjera për të rregulluar marrëdhënie të tilla cënon kompetencat e këtij organi (*shih vendimet nr. 30, datë 05.07.2021; nr. 20, datë 04.04.2014; nr. 20, datë 11.07.2016, të Gjykatës Kushtetuese*).

34. Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut është shprehur se që kriteri i kufizimit vetëm me ligj të konsiderohet i përmbushur nuk mjafton vetëm që të ekzistojë një ligj në kuptimin formal, por ky ligj duhet të jetë i aksesueshëm për publikun (*shih Muller v. Sëitserland App no. 10737/72; Ëingrove v. United Kingdom App no. 17419/90*) dhe i formuluar në mënyrë precize për t’u mundësuar individëve të rregullojnë sjelljen e tyre në përputhje me rrethanat ose e thënë ndryshe në mënyrë që individët të mund të parashikojnë me saktësi pasojat e veprimeve të tyre (*shih de Groot v. Netherlands; Gaëeda v. Poland App no. 26229/95; Maestri v. Italy App no. 39748/98*). Pra, GJEDNJ nuk kërkon vetëm ekzistencën formalisht të një ligji, por kërkon që edhe përmbajtja e tij të plotësojë disa kriterë, sic janë qartësia dhe parashikueshmëria e pasojave.

35. Duke u kthyer në rastin konkret, rezulton se aktet normative objekt i kësaj kërkesë, megjithëse janë miratuar me ligjin nr. 39/2022 dhe nr. 42/2022, cka do të thotë se nga pikëpamja formale përmbushin elementin e kufizimit me ligj, në fakt po të vërejmë përmbajtjen e tyre rezulton se nuk përmbushet standardi i vendosur nga jurisprudenca e GJEDNJ, që ka të bëjë me formulimin e saktë dhe në mënyrë precize të ligjit. Konkretisht, në nenin 21/1, pika 1 janë parashikuar rastet

që do të konsiderohen situata të vecanta, të cilat nënkuptojnë edhe aplikimin e masave të vecanta, të parashikuara në Kreun III/1 të ligjit nr. 8450/1999 “Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre”. Pasi listohen katër raste të detajuara që do të përbëjnë situata të vecanta (gërma “a” – “ç”), në gërmën “d” parashikohen sit ë tilla edhe cdo situatë tjetër e krijuar në tregun ndërkombëtar, e cila ka sjellë deformime në tregun vendas. Ky përcaktim, në vlerësimin tonë, është shumë evaziv pasi i krijon hapësirë qeverisë që duke shfrytëzuar situata të caktuara që mund të krijohen në tregun ndërkombëtar, të ndërhyjë në treg me masa kufizuese ndaj operatorëve ekonomikë. Në referim të nenit 21/1, pika 2, situata e vecantë shpallet me vendim të Këshillit të Ministrave dhe kjo vendimmarrje nuk i nënshtrohet kontrollit parlamentar. Sistemi ekonomik në vendin tonë bazohet në ekonominë e tregut dhe lirinë e veprimtarisë ekonomike, prandaj cdo ndërhyrje apo kufizim në këto parime themelore, duhet të jetë sa më minimale dhe e justifikuar nga rrethana të jashtëzakonshme. Dhënia e një kompetencë të atillë qeverisë për të shpallur situatën e vecantë që nënkupton kufizime dhe ndërhyrje në lirinë e veprimtarisë ekonomike, çënon standardin e kufizimit vetëm me ligj, të vendosur nga GJEDNJ.

36. Një tjetër rast i mospërbushjes së standardit të vendosur nga GJEDNJ sa i përket qartësisë së ligjit dhe parashikimit të pasojave të tij, është neni 21/3, në të cilin janë parashikuar shprehimisht lista e kompetencave dhe përgjegjësi të Bordit. Por, në gërmën “ç” ndodhemi sërish përpara një përcaktim evaziv që lë hapësirë për interpretim dhe abuzim nga ana e këtij organi. Kështu, gërma “ç” parashikon se Bordi ka cdo kompetencë tjetër që vlerësohet e nevojshme në bazë të këtij kreu. Ky rregullim i përgjithshëm, pa ndonjë referencë të qartë në dispozita të tjera, krijon premisa për vendimmarrje në tejkalim të kompetencave të Bordit, e për rrjedhojë abuzive. Kjo pasi, një formulim i tillë i përgjithshëm që i lejon Bordit cdo kompetencë që lind e nevojshme sipas këtij kreu, krijon hapësira të gjëra interpretimi për kompetencat dhe përgjegjësitë reale që Bordi duhet të ketë sipas këtij akti. Po ashtu, mospërcaktimi i një afati për kohëzgjatjen e situatës së vecantë, duke e lënë tërësisht në diskrecionin e Bordit, vlerësojmë se nuk përmbushet standardet ndërkombëtare të kufizimit vetëm me ligj të një të drejte. Ky element do të analizohet më tej sa i përket përmbushjes së kriterit të proporcionalitetit, por edhe në këtë rast shërben për të treguar mospërbushjen e kriterit të parë që ka të bëjë me “*kufizimin vetëm me ligj*” të një të drejte apo lirie.

37. Kriteri i dytë, që duhet të merret në konsideratë nga ligjvënësi për kufizimin e një të drejtë ose lirie të parashikuar në Kushtetutë, është “*interesi publik*” ose “*mbrojtja e të drejtave të*

tjerëve". Në rastin konkret, pretendimi i qeverisë është se miratimi i këtyre akteve normative ka pasur për qëllim mbrojtja e konsumatorëve shqiptarë nga cmimet e larta të karburanteve. Në fakt, sic kemi analizuar edhe më lart qeveria ka pasur mundësi të përdorte mjete më pak kufizuese të të drejtave, sic janë ulja e detyrimeve financiare që i shtohen cmimit të karburanteve apo subvencionimi për qytetarët, ashtu si dhe mekanizmat ligjorë që garanton legjislacioni shqiptar për mbrojtjen e konkurrencës dhe mbrojtjen e konsumatorëve. Nga ana tjetër, sic ka rezultuar në praktikë në fakt masat e vecanta dhe Bordi kanë dështuar në qëllimin e tyre për të mbrojtur konsumatorin shqiptar nga cmimet e larta të karburantëve. Sic rezulton nga botime të ndryshme mediatike, por edhe një reagim zyrtar i Konfederatës së Industrive të Shqipërisë, Shqipëria ka aktualisht cmimin më të shtrenjtë të naftës në rajon, përkatësisht 33% dhe 25% krahasuar me Malin e Zi dhe Maqedoninë e Veriut që furnizohen në të njëjtat tregje ndërkombëtare (<http://ëë.konfindustria.al/mat.php?lang=1&idm=592>). Pra, edhe kriteri i dytë i interesit publik mbetet i papërbushur përsa kohë mjetet e zgjedhura për mbrojtjen e konsumatorit shqiptar kanë rezultuar joefektive.

38. Kriteri i tretë, lidhur me kufizimin, proporcionaliteti, nënkupton që ndërhyrja e ligjvënësit për kufizimin e një të drejte ose lirie të caktuar të bëhet me mjete të përshtatshme që i përgjën drejt qëllimit që synohet të arrihet. Një kusht tjetër që duhet të respektojë ligjvënësi në vendosjen e kufizimit është që ky kufizim të jetë në përpjesëtim me gjendjen që e ka diktuar atë. Ky kusht imponon ligjvënësin të evidentojë nevojën reale të ndërhyrjes në të drejtat individuale në një situatë konkrete. Baraspeshimi i ndërhyrjes, me gjendjen që e ka diktuar ndërhyrjen, imponon ligjvënësin të zbatojë mjete të tilla ligjore, të cilat duhet të jenë efektive, domethënë të zgjedhura në mënyrë të tillë që të jenë të përshtatshme për realizimin e synimeve që ndiqen. Përveç kësaj, përdorimi i këtyre mjeteve duhet të jetë i domosdoshëm, cka do të thotë se synimi nuk mund të arrihet me mjete të tjera. Domosdoshmëria ka të bëjë, gjithashtu, edhe me përdorimin e mjeteve më pak të dëmshme për subjektet që u cënohen të drejtat dhe liritë (*shih vendimet nr. 28, datë 30.06.2021; nr. 1, datë 16.01.2017; nr. 7, datë 16.02.2015, të Gjykatës Kushtetuese*).

39. Duke dashur të shmangin përsëritjet e panevojshme, është e qartë se nëse qëllimi a objektivi i qeverisë ka qenë mbrojtja e konsumatorit shqiptar nga rritja e cmimeve, kjo mund të kryhej fare mirë nga ulja, heqja a pezullimi i një a disa prej detyrimeve financiare që rëndojnë mbi cmimin e hidrokarbureve, si dhe dhënia e subvencioneve nëpërmjet shumave monetare për të përballuar rritjen e cmimeve. Këto janë praktika që janë ndjekur nga shuma vende të rajonit dhe

Bashkimit Evropian, si një përgjigje ndaj krizës ekonomike që ka shkaktuar pandemia dhe agresioni rus në Ukrainë. Nga ana tjetër, për të shmangur cdo lloj abuzimi që mund të kryhej ndaj qytetarëve, legjislacioni shqiptar për mbrojtjen e konkurrencës, mbrojtjen e konsumatorit, inspektimin e tregut, ofron mekanizma ligjorë dhe institucionalë të mjaftueshëm për të garantuar që sjellja e operatorëve ekonomikë nuk do të jetë në dëm të konsumatorit. Ndërhyrja nëpërmjet emërimit të një bordi me përbërje publiko-private, i cili cakton cmime dhe vendos masa administrative ndaj atyre që nuk i aplikojnë këto cmime, është ndërhyrja më flagrante dhe më pak e përshtatshme në lirinë e veprimtarisë ekonomike, veçanërisht në aspektin e konkurrencës që do të analizohet në vijim.

40. Gjykata Kushtetuese, në jurisprudencën e saj ka vlerësuar, gjithashtu, se, si rregull, cdo kufizim i të drejtave në vetvete duhet të ketë elementin e përkohshmërisë. Po ashtu, parimi i proporcionalitetit kërkon që sa më i madh të jetë kufizimi, aq më i detajuar dhe bindës duhet të jetë justifikimi i tij. Megjithatë, kur këto kufizime zgjasin pa afat, duke humbur karakteristën e përkohshmërisë dhe për kohëzgjatjen e pacaktuar nuk jepet justifikim, ato shndërrohen në ndalim tërësor të kësaj të drejte, duke zbehur rolin që luajnë në mënyrat alternative (*shih vendimin nr. 11, datë 09.03.2021 të Gjykatës Kushtetuese*). Duke u ndalur të përkohshmëria, si një nga elementët thelbësorë të parimit të proporcionalitetit, rezulton se neni 21/1, pika 2 e aktit normativ nr. 5/2022 përcakton se situata e vecantë shpallet me vendim të Këshillit të Ministrave. Ndërsa, neni 21/10 përcakton se parashikimet e këtij kreu zbatohen për aq kohë sa zgjat periudha e situatës së vecantë. Në pikën 2 të këtij neni, thuhet se përfundimi i situatës së vecantë përcaktohet me vendim të Bordit. Ky përcaktim është tërësisht abuziv dhe joproporcional, pasi e lë tërësisht në diskrecionin e qeverisë shpalljen e situatës së vecantë, dhe po ashtu përfundimin e kësaj situatë në vlerësimin e Bordit. Kushtetuta, në nenet 170 – 176 të saj, parashikon rastet e vendosjes së masave të jashtëzakonshme, si dhe kohëzgjatjen e tyre. Në cdo rast pas kalimit të këtyre afateve, zgjatja e masave i nënshtrohet kontrollit parlamentar. Ndërsa, në rastin konkret, akti normativ nuk ka parashikon një afat për kohëzgjatjen e situatës së vecantë, dhe as shpallja e saj, as shtyrja, as masat e ndërmarra nuk i nënshtrohen kontrollit parlamentar, cka vjen në kundërshtim të hapur me parimin e proporcionalitetit pasi çënohet përkohshmëria e kufizimit. Është fakt që nga data 12.03.2022 deri në datën e depozitimit të kësaj kërkesë kanë kaluar rreth 6 muaj, dhe masat e vecanta vijojnë të jenë në fuqi, pa pasur një datë apo afat të caktuar, se për sa kohë do të zgjasin.

D. Lidhur me cënimin e rregullave të MSA-së për konkurrencën

41. Neni 71 i ligjit nr. 9590, datë 27.07.2006 “Për ratifikimin e “Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Komuniteteve Europiane e shteteve të tyre anëtare” (në vijim “MSA”), përcakton se “1. Dispozitat në vijim nuk përputhen me funksionimin e duhur të Marrëveshjes, duke qenë se mund të ndikojnë në tregtinë ndërmjet Komunitetit dhe Shqipërisë: (i) të gjitha marrëveshjet ndërmjet sipërmarrjeve, vendimet e marra nga grupe sipërmarrjesh dhe praktikat e koordinuara ndërmjet sipërmarrjeve të cilat kanë si objektiv të tyre ose pasojë, parandalimin, kufizimin ose shtrembërimin e konkurrencës; (ii) abuzimi me pozicionin dominues, nga një ose më shumë sipërmarrje, në territoret e Komunitetit apo të Shqipërisë si një e tërë ose në një pjesë të konsiderueshme të tyre; (iii) cdo ndihmë shtetërore e cila shtrembëron ose rrezikon të shtrembërojë konkurrencën duke favorizuar sipërmarrje të caktuara ose prodhime të caktuara. 2. Praktikrat në kundërshtim me këtë nen vlerësohen në bazë të kriterëve që lindin nga zbatimi i rregullave të konkurrencës të aplikueshme në Komunitet, sidomos nenet 81, 82, 86 dhe 87 të Traktatit themelues të Komunitetit Europian dhe instrumenteve që përdoren nga institucionet e Komunitetit.”

42. Duke iu referuar nenit 101 të Traktatit për Funksionimin e Bashkimit Evropian, ish-nenit 81 të Traktatit themelues të Komuniteteve Europiane, i cili përcakton se “1. Sa më poshtë janë të ndaluara si të papajtueshme me tregun e brendshëm: të gjitha marrëveshjet midis ndërmarrjeve, vendimet e shoqatave të ndërmarrjeve dhe praktikrat e bashkërenduara të cilat mund të prekin tregtinë midis Shteteve Anëtare dhe të cilat kanë si objekt ose pasojë të tyre pengimin, kufizimin ose shtrembërimin e konkurrencës brenda tregut të brendshëm dhe, në vecanti, ato të cilat: (a) vendosin drejtpërdrejt ose tërthorazi cmimet e shitjes e të blerjes ose cdo kusht tjetër tregtimi; (b) kufizojnë ose mbajnë në kontroll prodhimin, tregjet, zhvillimin teknik ose investimet; (c) ndajnë tregjet ose burimet e furnizimit; (d) zbatojnë kushte jo të njëjta për transaksioneve të barasvlefshme me palë të tjera tregtare, duke i vendosur ato në pozitë të pafavorshme konkurrese; (e) lidhjen e kontratave e kushtëzojnë me pranimin nga ana e palëve të tjera e detyrimeve shtesë të cilat, për nga natyra ose për nga përdorimi tregtar, nuk kanë lidhje me objektin e kontratave të tilla. 2. Cdo marrëveshje apo vendim i cili është ndaluar në zbatim të këtij neni, është automatikisht pa vlerë ligjore.”

43. Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit, në nenin 71, dhe Traktati i Lisbonës, në nenin 101, kanë përcaktuar qartë që marrëveshjet e ndërmarrjeve që vendosin drejtpërdrejt ose tërthorazi cmimet e shitjes apo të blerjes, konsiderohen të ndaluara dhe automatikisht pa vlerë ligjore. Të vetmet raste përjashtimore nga ky rregull, janë ato marrëveshje që kontribuojnë në përmirësimin e prodhimit ose shpërndarjen e mallrave, ose në nxitjen e përparimit teknik, ose ekonomik, duke u lejuar konsumatorëve të kenë një pjesë të drejtë të përfitimit që rrjedh prej kësaj, dhe që: (a) nuk vendos mbi ndërmarrjet në fjalë kufizime që nuk janë të domosdoshme për arritjen e këtyre objektivave; (b) nuk u jep ndërmarrjeve mundësinë për ta eliminuar konkurrencën në lidhje me një pjesë të konsiderueshme të produkteve në fjalë (shih nenin 101, pika 3 TFEU-së).

44. Duke u kthyer në rastin konkret, neni 21/2 përcakton përbërjen e Bordit me 12 anëtarë, pesë prej të cilëve përfaqësues të shoqërive të hidrokarbureve. Sa i përket kriterit për përzgjedhjen e këtyre pesë anëtarëve, pika 6 e nenit 21/2 ka parashikuar se ata do të përzgjidhen nga 5 kompanitë hidrokarbure me xhiron vjetore më të lartë në vitin pararendës. Pra, pesë përfaqësuesit e kompanive më të mëdha hidrokarbure në vend, ulen në një tryezë së bashku me përfaqësuesit e qeverisë, për të dakordësuar cmimin e shitjes me shumicë dhe pakicë të gazit, naftës dhe nënprodukteve të tyre. Kjo praktikë është në kundërshtim flagrant me nenin 71, pika 1 të MSA-së dhe nenin 101, pika 1 të TFEU-së, pasi kemi të bëjmë me një marrëveshje ndërmjet ndërmarrjeve, të cilat vendosin drejtpërdrejt cmimet e shitjes me shumicë dhe pakicë të lëndëve hidrokarbure. Pikërisht, këto shoqëri janë të ngarkuara edhe me detyrën e sanksionimit me pezullim 3-mujor të licencës deri në heqje të licencës së aktivitetit tregtar dhe sekuestrim të stacionit të karburantit. Këto marrëveshje nuk përfshihen në asnjë prej rasteve përjashtimore të parashikuara në nenin 101, pika 3 të TFEU-së, përkundrazi si rezultat i këtyre praktikave qytetarët dhe bizneset kanë vuajtur shtrenjtimin e cmimit të karburanteve dhe lëndëve të tjera, përfshirë produktet ushqimore, cmimi i të cilave është rritur për shkak të rritjes së cmimit të hidrokarbureve. Kjo mund të dëshmohet edhe me faktin se qytetarët dhe bizneset, nëpërmjet protestave në sheshe, deklaratave dhe qëndrimeve publike janë shprehur kundër masave të vecanta të marra nga qeveria dhe vendimeve të Bordit. Në këto kushte, është e qartë se aktet normative objekt të kësaj kërkesë janë në kundërshtim me nenin 71, pika 1 të MSA-së, parë në raport me nenin 101 të TFEU (ish-neni 81 i TKE).

E. Lidhur me cënimin e barazisë para ligjit

45. Neni 18 i Kushtetutës përcakton se “1. Të gjithë janë të barabartë përpara ligjit. 2. Askush nuk mund të diskriminohet padrejtësisht për shkaqe të tilla si gjinia, raca, feja, etnia, gjuha, bindjet politike, fetare a filozofike, gjendja ekonomike, arsimore, sociale ose përkatësia prindërore. 3. Askush nuk mund të diskriminohet për shkaqet e përmendura në paragrafin 2, nëse nuk ekziston një përligjje e arsyeshme dhe objektive.” Një nga shkaqet e diskriminimit lidhet edhe me gjendjen ekonomike, cka nënkupton të ardhurat dhe shpenzimet që mund të ketë një person fizik apo juridik gjatë një kohe të caktuar. Kushtetuta është tregtuar shumë e qartë se askush nuk mund të diskriminohet për gjendjen ekonomike, përveçse kur ekziston një përligjje e arsyeshme dhe objektive. Kjo përligjje nëse bëhet në një akt ligjor apo nënligjor, duhet të arsyetohet në mënyrë të mjaftueshme, duke treguar shkaqet dhe arsyet e një zgjedhje të caktuar.

46. Duke u kthyer në rastin konkret, rezulton se ndër 12 anëtarët e Bordit, 5 janë përfaqësues të kompanive hidrokarbure me xhiron më të lartë të vitit pararendës. Këto kompani kanë të drejtë të marrin pjesë në vendimmarrje për caktimin e cmimeve të shitjes me shumicë dhe pakicë të gazit, naftës dhe nënprodukteve të tyre; kanë të drejtë të paraqesin të dhëna dhe informacione që disponojnë me qëllim ndikimin e vendimmarrjes, madje kanë të drejtë edhe të marrin masa administrative ndaj konkurrentëve të tyre, nga pezullimi i licencës deri në heqje të saj dhe sekuestrim të stacionit të karburantit. Qartazi, ky rregullim përbën një diskriminim të operatorëve të ndryshëm ekonomikë për shkak të gjendjes ekonomike, duke favorizuar operatorët me xhiron më të lartë, për rrjedhojë ata me të ardhura më të larta, dhe duke lënë jashtë vendimmarrjes operatorët e tjerë, të cilët mund të jenë më modestë në të ardhurat dhe shpenzimet e tyre, por që gjithësesi zëri dhe shqetësimet e tyre duhen dëgjuar. Aq më tepër që luhatjet e tregut dhe cmimeve i ndjejnë më shumë operatorët e vegjël, të cilët kanë mundësi më të pakta financiare për t’i përballuar.

47. Ky lloj diskriminimi për shkak të gjendjes ekonomike është shprehimisht i ndaluar nga neni 18, pika 2 e Kushtetutës. Qeveria nuk ka bërë asnjë përpjekje për të justifikuar apo për të përligjjuar arsyet e këtij diskriminimi që i bëhet operatorëve apo kompanive të mesme dhe të vogla, në raport me kompanitë më të mëdha të hidrokarbureve. Një mundësi që do të garantonte gjithëpërfshirje dhe trajtim të barabartë, mund të ishte përfaqësim me rotacion i shoqërive hidrokarbure në Bord. Ajo që në fakt e bën akoma edhe më flagrant diskriminimin dhe trajtimin e

padrejtë, është fakti që anëtarëve të Bordit, përfaqësues të shoqërive hidrokarbure, u njihet e drejta të marrin vendime dhe masa disiplinore shumë të rënda ndaj kompanive konkurrencte të tyre. Është rast unik në botë që një konkurrent në një sektor të caktuar mund të vendosë për konkurrentin tjetër nëpërmjet një ligj a akti normativ, që t'i pezullohet licenca apo edhe t'i hiqet licenca, deri edhe në sekuestrim të vendit ku ushtron aktivitetin. Do të mjaftonte ky absurd kushtetutes dhe ligjor, që cdo gjykatë në një shtet dhe shoqëri demokratike, ta deklaronte këtë akt të pavlefshëm e për rrjedhojë të vendoste shfuqizimin e tij.







IV. KONKLUZIONE

48. Prandaj, duke pasur parasysh sa më sipër, bazuar në nenin 11, 18, 101, 131 dhe 134 të Kushtetutës së Shqipërisë, nenin 71 të ligjit nr. 9590, datë 27.07.2006 "Për ratifikimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Komuniteteve Europiane e shteteve të tyre anëtare" dhe nenet 27, 49, 50 dhe 51 të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese", i ndryshuar, përfundimisht kërkojmë:

- (i) Shfuqizimin e ligjit nr. 39/2022 "Për miratimin e aktit normativ, me fuqinë e ligjit, nr. 5, datë 12.03.2022, "Për disa shtesa në ligjin nr. 8450, datë 24.02.1999, "Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre", të ndryshuar";
- (ii) Shfuqizimin e ligjit nr. 42/2022 "Për miratimin e aktit normativ, me fuqinë e ligjit, nr. 8, datë 25.03.2022, "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8450, datë 24.02.1999, "Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre", të ndryshuar".

Me konsideratë,

DEPUTETËT

1-	Garment	Barshi	
2-	Flamuri	Made	
3-	Helidon	Qereti	
4-	Ilumeta	Cupi	
5-	Saimir	Laneshi	
6-	Sebestin	Jlyello	

7. Merita Bagieu ~~MB~~
8. Relema Alay ~~AA~~
9. Ilda Shari ~~DS~~
10. Lheri Gersi G
11. Zoralda Haruo ~~Haruo~~
12. Desnosfula ~~DS~~
13. Andia Ulliri ~~Ulliri~~
14. ~~Zury Fey Fey~~
15. CRIDA DUMA ~~DUMA~~
16. Kresnik Lohetu ~~LD~~
17. Linolita Metahior ~~Metahior~~
18. guta Zedeli ~~Zedeli~~
19. Bledham Melkoti ~~Melkoti~~
20. Enain Solioji ~~Solioji~~
21. FERDINANT KHATERAJ ~~Khateraj~~
22. Jester Geshenja Kostetja ~~Kostetja~~
23. ORJOLA PAMPURI ~~Pampuri~~
24. Arim Aetun ~~Aetun~~
25. Jurela Tedeher ~~Tedeher~~
26. Dulzim Bopke ~~Bopke~~
27. ~~Alfred Rusthaj~~
29. ALFRED RUSTHAJ ~~Rusthaj~~